

**GAZETAT ME HISTORI - SHKOJNË NË HISTORI!****ВЕСНИЦИ СО ИСТОРИЈА - ОДАТ ВО ИСТОРИЈА!****NEWSPAPERS WITH HISTORY - GO IN HISTORY!****Abstract**

*Trends of globalization and rapid technological development largely are being implemented in the media. A kind of incidental victim of these trends has especially become the print media. As a result, everywhere around the world, the circulation of newspapers it is declining, as a result of the massive spreading of the Internet and information consumption in the form of online. Even respective newspapers and magazines continue to extinguish in the form of printed version, which are unable to cope with new technical and technological circumstances.*

*In the Albanian area, all the traditional newspapers have already been extinguished, those that many generations identify with. The most long-lived newspaper of Albania, "Zëri i Popullit" (Tirana) disappeared, the identifying newspaper of Kosovo, "Rilindja" (Pristina) disappeared, the most popularized newspaper of the Albanians in Macedonia and wider, "Flaka e vëllazërimit" (Skopje) disappeared, the "Koha" (Ulcinj) of the Montenegro Albanians disappeared, or even "Jehona" of the Albanians of Presevo Valley which gets published periodically with a lot of difficulty.*

*Unfortunately, all these newspapers which more than five decades survived the communist regime, slowly faded away and got lost*

---

<sup>1</sup> Dr. Sevdail Demiri, është bashkëpunëtor i lartë shkencor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. (sevdaildemiri@yahoo.com)

*forever in the period of democracy, exactly when everyone thought that the possibilities for the development and progress of the press were greater. On the other hand, if we draw a parallel, in all the Balkan neighbor countries, the traditional press not only that it hasn't terminated, but it has also progressed and strengthened with the technological development over time.*

**Key words:** *print media, traditional newspapers, online, "Zëri i Popullit", "Rilindja", "Flaka e vëllazërimit"*

### **Hyrje:**

Trendët e globalizimit dhe zhvillimit të hovshëm tekniko-teknologjik, në masë të madhe po zbatohen edhe në media. Një lloj viktime e këtyre trendëve janë bërë sidomos mediat e shkruara.

Viteve të fundit, gjithkrah nëpër botë është duke rënë dukshëm tirazhi i gazetave, si rezultat i përhapjes masive të internetit dhe konsumimit të informacionit në formën "online". Madje, edhe janë shuar dhe vazhdojnë edhe më tutje të shuhen gazeta e revista respektibile në formën e shtypur, të cilat nuk arrijnë dot t'i përballojnë rrethanave të reja. Kështu për shembull, në vitin 2009, pas gjithsej 150 viteve ekzistim, u shua edhe një nga gazetatat më të vjetra në SHBA "Roki mauntin njuz"<sup>2</sup>. Gazeta e vetme shtetërore në Kroaci "Vjesnik", u mbyll në vitin 2012, për shkak të borxheve të mëdha<sup>3</sup>. Edhe gazeta tradicionale "Borba"<sup>4</sup> e Beogradit u shua pas gati 90 viteve ekzistencë. Kështu janë mbyllur edhe një numër i madh i gazetave ditore evropiane e botërore. Kohë më parë në Hungari u mbyll gazeta ditore politike me traditë 60-vjeçare "Nepszabadsag", po ashtu për shkak të problemeve ekonomike<sup>5</sup>.

Por, megjithëkëtë, shoqëritë me koncepte më të qarta shtetformuese dhe me ndërgjegje më të larta kombëtare, gjejnë forma dhe mënyra për t'i ruajtur organet e tyre të shtypit që kanë përshkruar të kaluarën dhe historinë e tyre nëpër periudha më të gjata kohore.

Shumica e gazetave tradicionale nëpër botë dhe vendet evropiane e ballkanike, vazhdojnë të funksionojnë edhe në versionin e shtypur, edhe në atë "online". Por, ato që aty-këtu e kanë ndaluar formatin e shtypur, vazhdojnë të punojnë gati se me të njëjtat kapacitete në formatin "online".

<sup>2</sup> <http://www.idividi.com.mk/Shqip/Bote/508638/>, shikuar më 12.2.2018;

<sup>3</sup> <http://www.albinfo.ch/shuhet-vjesnik-i-kroacise/>, (12.2.2018);

<sup>4</sup> [https://sh.wikipedia.org/wiki/Borba\\_\(novine\)](https://sh.wikipedia.org/wiki/Borba_(novine)), (12.2.2018);

<sup>5</sup> <http://aa.com.tr/sq/bota/mbyllet-gazeta-nepszabadsag-n%C3%AB-hungari/661217>, (12.2.2018);

Kështu për shembull, nëse marrim shtetet që na rrethojnë, në Beograd (Serbi) vazhdon të botohet në të dyja versionet gazeta e traditës “*Politika*”<sup>6</sup>, e cila daton nga viti 1909, në Shkup (Maqedoni) vazhdon të botohet po ashtu në të dyja versionet gazeta “*Nova Makedonija*”<sup>7</sup> (që nga viti 1944), etj.

Por, në vijim të shohim se si është gjendja me shtypin shqiptar të traditës, nëpër të cilin do të bëjmë edhe një “ekskursion historik”.

Në hapësirën shqiptare tanimë janë shuar gati se të gjitha gazetat tradicionale, me të cilat identifikohen breza të tërë. U shua gazeta më jetëgjatë e Shqipërisë “Zëri i Popullit” (Tiranë), u shua gazeta identitare e Kosovës “Rilindja” (Prishtinë), u shua gazeta më popullarizuese e shqiptarëve të Maqedonisë dhe më gjerë “Flaka e vëllazërimit” (Shkup), u shua “Koha” e shqiptarëve të Malit të Zi (Ulqin), apo edhe “Jehona” e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, e cila me vështirësi botohet në mënyrë periodike.

Fatkeqësisht, të gjitha këto gazeta që më se pesë dekada i mbijetuan regjimit komunist, dalëngadalë u zvetënuan dhe u humbën përjetësisht në periudhën e demokracisë, pikërisht atëherë kur të gjithë menduam se mundësitë për zhvillimin dhe avancimin e shtypit janë më të mëdha.

A thua, pse e gjithë kjo neglizhencë dhe vetëdije e ulët për ruajtjen e shtypit tradicional shqiptar, e cila realisht është një trashëgimi shumë e pasur kulturore?! Pse e gjithë kjo pakujdesi ndaj titujve emblematic të shtypit shqiptar, me të cilët u rritën e u kalitën gjenerata të tëra?! A është vërtetë kriteri financiar apo ai subjektiv, më “meritori” për mbylljen e këtyre gazetave?! Këto dhe çështje të tjera, mëtojmë t’i shtjellojmë përmes këtij punimi shkencor, që ka për qëllim sqarimin e këtij problemi të shoqërisë shqiptare, por edhe ndezjen e alarmit për humbjen para syve tanë të një trashëgimie kulturore të pakrahasueshme dhe të papërsëritshme.

### ***Gazeta “Dielli” - SHBA***

Siç pranohet në historinë e gazetarisë shqiptare, gazeta me më shumë jetëgjatësi e botës shqiptare, është “*Dielli*”<sup>8</sup>. Numri i parë i saj doli në Boston të SHBA-ve, më 15 shkurt 1909, si organ i Federatës panshqiptare të Amerikës “Vatra”, ku vijoi të botohet deri më 1992, përkatësisht 2006, dhe me disa ndërprerje e vazhdoi botimin e shtypur

<sup>6</sup> <http://www.politika.rs>, (12.2.2018);

<sup>7</sup> <http://www.novamakedonija.com.mk/>, (12.2.2018);

<sup>8</sup> <https://en.wikipedia.org/wiki/Dielli> dhe <http://gazetadielli.com/>, (12.2.2018);

nga viti 2011, por vetëm në raste dhe data të veçanta, kurse sot është aktive në formatin online<sup>9</sup>.

“*Dielli*” gjatë kësaj jete shekullore, ka ndërruar shumë botues, me bindje dhe pikëpamje të ndryshme politike e ideologjike. Emrat më përfaqësues të saj mbeten Fan Noli, Faik Konica e Kristo Floqi<sup>10</sup>.

Që nga viti 2009, kur i kishte mbushur një shekull jetë, gazeta “*Dielli*” editohet nën përkujdesjen e gazetarit Dalip Greca, nga selia e Federatës Panshqiptare të Amerikës “*Vatra*”, në Bronks të Nju Jorkut. Kjo gazetë emblematike e shtypit shqiptar, me shumë vështirësi financiare arrin të mbahet gjallë si gazetë mujore, kryesisht falë “xhelozisë” së atdhetarëve vatanë, për të mos e shuar traditën. Gazeta në formatin online dhe atë të shtypur, është mjaft aktive me informacione të llojeve të ndryshme për dhe rreth komunitetit shqiptar në SHBA dhe në trojet etnike shqiptare.

Por, e përballur me shumë pengesa dhe sidomos me “fshesën moderne të globalizimit”, kjo gazetë gjendet para një sprove shumë të madhe, nëse do të arrijë që ta vazhdojë misionin e saj fisnik dhe të mos e venitë këtë emër të madh dhe me traditën më të gjatë në historinë e shtypit shqiptar.

### ***Gazeta “Zëri i Popullit” – Tiranë***

Gazeta “*Zëri i Popullit*” e Tiranës, u themelua më 25 gusht 1942 në ilegalitet, dhe redaktuar fillimisht nga Enver Hoxha<sup>11</sup>. Pas luftës ajo u bë gazeta zyrtare e Shqipërisë dhe ishte organi kryesor i propagandues i Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH). Pas vitit 1991 gazeta vazhdoi të botohet si organ shtypi të së njëjtës parti, e cila në qershor 1991 ndryshoi emrin e saj në Partia Socialiste e Shqipërisë (PSSH).

Në mesin e viteve 80-ta, “*Zëri i Popullit*” arriti tirazh prej 110,000 kopje. Në fillim të viteve 1990 qarkullimi i saj ishte me 20,000 kopje, duke u bërë gazeta e dytë më e shitur në vend. Në vitin 2002 gazeta bie në 5,167 kopje, kurse qarkullimi i saj u rrit shumë në vitin 2005 kur arriti në 35,000 kopje, duke u bërë e përditshmja më e lexuar në Shqipëri. Në kohën e saj të artë, kishte afër 40 gazetarë, por secili numër i ditës, çdo mëngjes gjendej në tavolinën e punës të diktatorit Hoxha.

<sup>9</sup> <http://www.gazetadielli.com/>, (13.2.2018);

<sup>10</sup> Blendi Fevziu, *Histori e shtypit shqiptar (1848-2005)*, Onufri, Tiranë, 2005, f. 148.

<sup>11</sup> [https://en.wikipedia.org/wiki/Zëri\\_i\\_Popullit](https://en.wikipedia.org/wiki/Zëri_i_Popullit) dhe [https://sq.wikipedia.org/wiki/Zëri\\_i\\_Popullit](https://sq.wikipedia.org/wiki/Zëri_i_Popullit), shikuar më (13.2.2018);

“Zëri i Popullit” e ndali botimin e shtypit në nëntor të vitit 2015. Gazeta zyrtare e Partisë Socialiste në versionin e printuar është mbyllur me urdhër të kryetarit të PS-së, Edi Rama, i cili nuk ka pasur ndonjë simpati të veçantë për të, për shkak të “bagazhit ideologjik të së shkua-rës”. Pra, pas 65 vjetëve në tregun e shtypit të shkruar shqiptar, duke qenë gazeta e dytë për nga jetëgjatësia në historinë e shtypit shqiptar, “Zëri i Popullit” rreth dy vite pas shuarjes u gjet në versionin “online”, që pas një kohe të shkurtër të ndërpritet fare, duke humbur çdo gjurmë! Me shuarjen e saj u shua një trashëgimi mjaft e pasur kulturore, pava-rësisht ngarkesës ideologjike që kishte gjatë viteve të gjata të sistemit komunist shqiptar.

### **Gazeta “Bashkimi” – Tiranë**

“Bashkimi” ishte gazeta e dytë për nga rëndësia në Shqipërinë komuniste, pas “Zërit të Popullit”. Numri i saj i parë u botua më 25 mars 1943 në Durrës, dhe ishte organ i të ashtuquajturit Fronti Demo-kratik (më vonë Fronti i Kuq Popullor), duke e përkrahur që në fillim dhe pa rezerva, lëvizjen komuniste shqiptare.

Me gazetën “Bashkimi” lidhet periudha më e artë e gazetarisë shqiptare sidomos në vitet e para (1945-46), kur udhëhiqej nga gazetari dhe shkrimtari i njohur, Petro Marko.

“Bashkimi” ishte gazetë që kishte shumë ngjashmëri me “Zërin e Popullit”, dhe zakonisht u bënte jehonë lajmeve që botoheshin në këtë të dytën. Rëndësia e saj mori fund pas vitit 1991, kur pas disa për-pjekjeve të pasuksesshme për mbijetesë në treg, u shua krejtësisht<sup>12</sup>. Me emrin “Bashkimi” kanë provuar të dalin edhe disa gazeta të tjera në Shqipëri, Kosovës e diasporë, por asnjëra nga to nuk ka pasur jetë stabile.

### **Gazeta “Rilindja” - Prishtinë**

Meqë pas Luftës së Dytë Botërore, populli shqiptar mbeti të jetojë i ndarë në disa njësi shtetërore, përkatësisht njëra gjysmë në Republikën e Shqipërisë, kurse gjysma tjetër në Jugosllavi (Kosovë, Maqedoni, Serbi, Mal të Zi, etj.), edhe shtypi shqiptar reflektonte gjendjen dhe realitetet e reja të krijuara në këto hapësira. Por, gjurmë më të thella në historinë e gazetarisë shqiptare, ka lënë shtypi i zhvilluar në Tiranë, në Prishtinë dhe në Shkup. Në Kosovë, arritjet më të mëdha në këtë drejtim

<sup>12</sup> B.Fevziu, *po aty*, f. 83-84.

në fushën e gazetarisë dhe informimit u bënë me botimin e gazetës “Rilindja”.

Më 12 shkurt të vitit 1945, në Prizren u botua numri i parë i “Rilindjes”, si organi i Frontit Popullor në Kosovë. Prej numrit 61, gazeta vazhdoi të botohet në Prishtinë, në Shtypshkronjën Krahinore të Frontit Popullor. Në fillim ishte e përjavshme vetëm me katër faqe deri më 27 qershor 1948, kur fillon të dalë dy herë në javë, kurse nga nëntori i vitit 1958 bëhet e përditshme (përveç ditëve të premte). “Rilindja” ishte pa dyshim gazeta më e lexuar dhe më e shitur në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi, ndërsa tirazhi maksimal gjatë festave të Vitit të Ri, ka arritur deri në 234.000 ekzemplarë<sup>13</sup>.

Me gazetën “Rilindja” janë rritur shumë gjenerata dhe në të janë kalitur shumë intelektualë, shkrimtarë e veprimtarë kulturorë e politikë nga të gjitha anët e ish-Jugosllavisë.

Në vitin 1990, nga pushteti serb u ndalua botimi i kësaj gazete, ndërsa pas hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë më 1999, ajo doli përsëri në treg. Gazeta “Rilindja” përfundimisht ka pushuar së botuari që nga viti 2009.

Gazeta tradicionale e Kosovës “Rilindja” është një pasuri kombëtare, me një traditë të gjatë, aq sa ka gazeta e njohur franceze “Le Monde” e Parisit, e që krahasohet edhe me traditat e gazetave të tjera të shteteve me demokraci më të përparuara në botë<sup>14</sup>.

Shuarja e kësaj gazete, në të cilën përmbledhet një histori më se gjysmëshekullore e shqiptarëve të Kosovës, pa dyshim është një humbje e madhe për gazetarinë dhe publicistikën shqiptare në përgjithësi. Rikthimi i saj i mundshëm në treg, qoftë edhe në mënyrë simbolike, do të fliste shumë për respektin ndaj traditës, vlerave të mirëfillta dhe të kaluarës sonë. Mirëpo, deri më tani, përpos aty-këtu ndonjë fjale vullnetmire, nuk është bërë asgjë konkrete në drejtim të funksionalizimit të këtij bendi të rëndësishëm të gazetarisë shqiptare. Institucionet kosovare nuk kanë shprehur asnjë interesim për të, edhe pse Qeveria e ka marrë të gjithë ndërtesën gjigante të NGB “Rilindja” në Prishtinë.

Fatkeqësisht, gazeta “Rilindja” nuk botohet as në versionin “online”, si një mundësi shumë më e lehtë për mirëmbajtje dhe me kosto të ulët financiare.

<sup>13</sup> [https://sq.wikipedia.org/wiki/Rilindja\\_\(gazetë\)](https://sq.wikipedia.org/wiki/Rilindja_(gazetë)), (15.2.2018);

<sup>14</sup> [www.koha.net/?id=27&l=44476](http://www.koha.net/?id=27&l=44476), (15.2.2018);

### ***Gazeta “Flaka e vëllazërimit” – Shkup***

Kur flitet për historinë e shtypit shqiptar në Maqedoni, asocia-  
cioni i parë është gazeta më jetëgjate e kësaj treve shqiptare, “Flaka e  
vëllazërimit”<sup>15</sup>.

Numri i parë i saj doli më 4 prill të vitit 1945 në Shkup, duke qenë  
organ i Shtabit Kryesor të Frontit Popullor të Maqedonisë, e më vonë i  
Lidhjes Socialiste të Popullit Punues të Maqedonisë. Një rol të madh në  
botimin e kësaj gazete kishte dr. Nexhat Agolli, ministër i Politikës  
Sociale në Qeverinë e parë të Maqedonisë. Ndërsa, drejtor dhe  
kryeredaktor i parë i kësaj gazete ishte dr. Petro Janura.

Në fillim gazeta kishte probleme të shumta gjatë procesit të  
shtypit, me botim jo të rregullt. Duhej të dilte nga shtypi një herë javë,  
kurse shpeshherë vonohej nga dhjetë ditë, madje edhe deri në dy javë.  
Që nga viti 1971, “Flaka...” filloi të botohej tri herë në javë, por me  
kalimin e viteve, filloi të rritet numri i lexuesve, sikurse edhe nevoja për  
përhapjen e informacioneve, dhe bashkë me të edhe propagandës  
politike në mesin e popullatës shqiptare në Maqedoni dhe më gjerë.

Në gazetën “Flaka e vëllazërimit” vazhdimisht shkruhej historia  
e qytetarit shqiptar të Maqedonisë, problemet e tij, nevojat, kërkesat,  
idetë dhe shpresat për një të nesërme më të mirë. Për këtë, gazeta ishte  
e pasur me rubrika dhe materialet të llojllojshme, të cilat preknin  
thellësisht në qenien e shqiptarit. Veçanërisht dallohej rubrika e kultu-  
rës dhe e arsimit, e cila ndodhej në një nivel të lartë artistik dhe  
profesional.

Nga viti 1994 bëhet e përditshme, por fatkeqësisht duke vazhduar  
të jetë nën kontrollin e partive politike shqiptare që ishin pjesë e  
pushtetit të Maqedonisë. Gazeta “Flaka e vëllazërimit”, e cila tanimë e  
kishte shkurtuar emrin në “Flaka”, vazhdoi botimin deri në vitin 2004,  
kur pas privatizimit të saj (u shit për më pak se 3.000 euro), u shua  
plotësisht!

Ndërprerja e botimit të kësaj gazete pas gjashtë dekadave (nëntor  
2004), paraqet humbje të madhe për historinë e shtypit shqiptar në  
Maqedoni, dhe në përgjithësi për historinë e shqiptarëve të këtyre  
hapësirave.

As gazeta “Flaka” nuk ka të paktën një botim serioz në ndonjë  
platformë “online”.

<sup>15</sup> Sevdail Demiri, “Shtypi shqiptar në Maqedoni (1945-1991), aspekti kulturor-arsimor”,  
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve-Shkup, 2015, f.221.

***Revista “Koha (javore)” – Podgoricë***

Shtypi i shkruar në mesin e shqiptarëve të Malit të Zi, nisi me revistën për kulturë “Koha” (1979-1990), ku brenda këtij harku kohor dolën 54 numra, dhe për herë të parë sprovohen penat e reja që më vonë do të jenë emra të njohur në fushën e kulturës, letërsisë dhe artit<sup>16</sup>.

Gjatë kohës së pluralizmit politik në këtë hapësirë shqiptare nën Malin e Zi, pati disa përpjekje individuale për të botuar revista e gazeta shqipe, por që fatkeqësisht nuk patën jehonën e duhur dhe jetëgjatësi.

Sot në Malin e Zi, nga buxheti shtetëror botohet gazeta javore për aktualitete, shkencë dhe kulturë “Koha javore”<sup>17</sup>, emri i së cilës lidhet me revistën e parë që e përmendëm më lartë.

Themelues i “Kohës javore” është Kuvendi i Malit të Zi, ndërsa numri i parë i saj doli më 21 shkurt 2002. Redaksia është e vendosur pranë Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Podgoricë, edhe pse jeta shoqërore, politike, kulturore e arsimore e shqiptarëve të Malit të Zi, kryesisht zhvillohet në Ulqin, si qyteti me kompaktësi më të madhe etnike shqiptare në këtë republikë. Megjithatë, është shumë me rëndësi kontinuiteti i kësaj reviste, që duhet të mbahet me çdo kusht nga gazetarët dhe përfaqësuesit politik të shqiptarëve të Malit të Zi.

***Revista “Jehona” – Tërrnoc (Bujanoc)***

Në mesin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, revista e vetme që pati një jetë më të gjatë të veprimtarisë së saj ishte “Jehona”, e cila që nga fillimet ishte organ i SHKA “Jehona” e Tërrnocit, Komuna e Bujanocit. Gjatë vitit 1977 botohej si fletushkë, e më vonë merr fizionominë e revistës mujore informative, politike dhe kulturore, për të vazhduar pastaj si dyjavore e javore. Drejtues i saj në fillim ishte Skender Gashi. Shtypej me shaptilograf, në një lokal në fshatin Tërrnoc, në gjithsej dhjetë faqe. Në brendinë e saj gjenin vend krijimet e shkollarëve të kësaj komune, e aty-këtu ndonjë krijim i poetëve e shkrimtarëve të njohur të kohës.<sup>18</sup>

Revista “Jehona” e Tërrnocit pati disa ndërprerje të botimit të saj, sidomos gjatë luftërave në hapësirën ish-jugosllave. Tani herë pas here

<sup>16</sup><http://telegraf.al/kulture/ali-salaj-mediati-ne-gjuhen-shqipe-ne-mal-te-zi>, (15.2.2018);

<sup>17</sup> [www.kohajavore.org](http://www.kohajavore.org), (15.2.2018);

<sup>18</sup> Artikull në blogun e autorit Ferid Selimi: [www.feridselimi.wordpress.com/2015/03/19/informimi-shqip-dhe-rol-i-tij-gjate-viteve-te-nentedhjete-te-shekullit-xx-ne-lugine-te-presheves/](http://www.feridselimi.wordpress.com/2015/03/19/informimi-shqip-dhe-rol-i-tij-gjate-viteve-te-nentedhjete-te-shekullit-xx-ne-lugine-te-presheves/), (15.2.2018);



vazhdon të botohet si revistë periodike, sidomos gjatë datave të rëndësishme kombëtare, por që në thelb e ka humbur kontinuitetin.

Në këtë rajon shqiptar të mbetur nën Serbi, së fundi u patën botuar edhe revista tjera në gjuhën shqipe (“Perspektiva”, “Nacionali”), të mbështetura nga organet shtetërore, por që fatkeqësisht edhe ato e ndalën botimin, pas disa numrave modest.

### ***Përfundim:***

Shtypi tradicional shqiptar, si në Shqipëri e Kosovë, por edhe në viset tjera të rajonit ballkanik të banuara me shqiptarë, fatkeqësisht e ka humbur kontinuitetin. Janë ndërprerë botimet e të gjitha gazetave tradicionale, të cilat janë zëvendësuar me emra të rinj. Me ndërprerjen e këtyre botimeve, është ndërprerë një hallkë shumë e rëndësishme e zinxhirit kulturor e kombëtar të shqiptarëve.

Pa dyshim, është kjo një humbje jo e vogël e trashëgimisë sonë kulturore, e cila më së paku është dashur të ndodhë, pikërisht në këtë kohë, kur mundësitë për të mbajtur gjallë kulturën dhe traditën tonë, janë më të mëdha se kurrë. Pra, nuk mbajnë arsyet e llojit se, gjoja këto gazeta të traditës, janë shuar për shkaqe financiare. Kur po mund ende të mbijetojnë në treg dhjetëra gazeta ditore, pa kurrfarë problemi do të mund të mbijetonin edhe gazetat e traditës, me të cilat u rritën breza të tërë.

Prandaj, rikthimi në treg i titujve të njohur të gazetarisë shqiptare, si “Zëri i Popullit” në Tiranë, “Rilindja” në Prishtinë apo “Flaka” në Shkup, duhet të jetë impenjim i vazhdueshëm jo vetëm se i atyre që janë të lidhur emocionalisht me këto gazeta, por edhe i përfaqësuesve të shteteve respektive apo biznesmenëve me vetëdije të lartë kombëtare.

Rikthimi i këtyre brendeve të rëndësishëm në historinë e gazetarisë shqiptare, mund të bëhet fare lehtë me ndarjen e një fondi modest të kuvendeve apo qeverive gjegjëse. Nëse ato fonde nuk do të mjaftojnë për versionin e shtypur të këtyre gazetave, atëherë le të jetësohen në versionin “online”, me shumë pak punëtorë dhe kosto minimale financiare!

Duhet vetëm vullneti i mirë dhe dëshira për të bërë punë të mira, të tjerat vijnë pas!

### **Conclusion**

*Unfortunately, the traditional Albanian press, as in Albania and Kosovo, but also in other parts of the Balkan region inhabited by Albanians, has lost its continuity. There were discontinued all traditional newspapers, and were replaced with new names. With the termination of these publications is interrupted a very important link in the chain of the Albanian national culture.*

*Undoubtedly, this is not a small loss of our cultural heritage, which at least is supposed to happen at this time, when opportunities to sustain our culture and tradition, are greater than ever. Therefore, reasons that these traditional newspapers have supposedly been extinct for financial issues are unjustifiable. If there can still survive in the market dozen daily newspapers, without any problems, traditional newspapers could also survive, which grew generations.*

*Therefore, the return on the market of known Albanian press as "Zëri i Popullit" in Tirana, "Rilindja" in Pristina or "Flaka" in Skopje, should be continual commitment not only for those who are connected emotionally with these papers, but also of representatives of respective countries or businessmen with a strong national consciousness. The good will and the desire to do good works come after!*

### **Literatura e konsultuar:**

1. Boriçi H., M.Marku, *Historia e shtypit shqiptar - nga fillimet e deri në ditët tona*, SHBLU, Tiranë, 2010;
2. Demiri Sevdail, *"Shtypi shqiptar në Maqedoni (1945-1991), aspekti kulturor-arsimor"*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve, Shkup, 2015;
3. Fevziu Blendi, *Histori e shtypit shqiptar (1848-2005)*, Onufri, Tiranë, 2005;
4. Hoxha Sherafedin, *Shtypi i kombeve dhe kombësive të Kosovës (1871-1983)*, Rilindja, Prishtinë, 1987;
5. Krasniqi Milazim, *Ekskomunikimi - si histori e fshehur*, Rozafa, Prishtinë, 2016;

**Burimet e internetit:**

1. <http://www.idividi.com.mk/Shqip/Bote/508638/>
2. <http://www.albinfo.ch/shuhet-vjesnik-i-kroacise/>
3. [https://sh.wikipedia.org/wiki/Borba\\_\(novine\)](https://sh.wikipedia.org/wiki/Borba_(novine))
4. <http://aa.com.tr/sq/bota/mbyllet-gazeta-nepszabadsagn%C3%AB-hungari/661217>
5. <http://www.politika.rs>
6. <http://www.novamakedonija.com.mk/>
7. <https://en.wikipedia.org/wiki/Dielli>
8. <http://gazetadielli.com/>
9. <http://www.gazetadielli.com/>
10. [https://en.wikipedia.org/wiki/Zëri\\_i\\_Popullit](https://en.wikipedia.org/wiki/Zëri_i_Popullit)
11. [https://sq.wikipedia.org/wiki/Rilindja\\_\(gazetë\)](https://sq.wikipedia.org/wiki/Rilindja_(gazetë))
12. [www.koha.net/?id=27&l=44476](http://www.koha.net/?id=27&l=44476)
13. <http://telegraf.al/kulture/ali-salaj-mediat-ne-gjuhen-shqipe-ne-mal-te-zi>
14. [www.kohajavore.org](http://www.kohajavore.org)
15. <https://feridselimi.wordpress.com/2015/03/19/informimi-shqip-dhe-rol-i-tij-gjate-viteve-te-nentedhjeta-te-shekullit-xx-ne-lugine-te-presheves/>